





**SHOQATA HUMANITARE BËMIRËSE „NËNA TEREZE” - Strugë**  
**ХУМАНИТРАНО ДОБРОЧИНИТЕЛНО ЗДРУЖЕНИЕ „МАЈКА ТЕРЕЗА“ - Струга**  
**HUMANITÄREN UND GEMEINNÜTZIGEN VEREIN „MUTTER TERESA” - Struga**  
**contact phone: +38970249114**  
**e-mail : motherteresastruga@gmail.com ; jasharpollozhani1@gmail.com**  
**address: Kej 8-mi Noemvri 18,6330 Struga, MACEDONIA**



---

## **PROPOZIM PROJEKT:** **USHQIM PËR REFUGJATËT NGA LINDJA E MESME SI FOSHNJAT DHE FËMIJËT**

Këto njerëz tani më kanë ngelur në rrugë pa kthim, pa të afërmit, pa të dashurit, pa shtëpi, pa shkolla dhe shumë e shumë të drejta të tjera që i takojnë njerëzimit dhe me keqardhje themi se atyre ju ka ngelur vetem jeta, andaj të japim kontributin tonë që së paku t'ua ruajmë jetën

---

**DREJTUAR:**

**VENDI I REALIZIMIT:**

**MAQEDONIA VERIORE**  
**KUMANOVË/PIKA KUFITARE TABANOVÇ**

**APLIKUESI:**

**SHOQATA HUMANITARE BËMIRËSE**  
**“NËNA TEREZE” – STRUGË**



**SHOQATA HUMANITARE BËMIRËSE „NËNA TEREZE” - Strugë**  
**ХУМАНИТРАНО ДОБРОЧИНИТЕЛНО ЗДРУЖЕНИЕ „МАЈКА ТЕРЕЗА“ - Струга**  
**HUMANITÄREN UND GEMEINNÜTZIGEN VEREIN „MUTTER TERESA” - Struga**

contact phone: +38970249114

e-mail : motherteresastruga@gmail.com ; jasharpollozhani1@gmail.com

address: Kej 8-mi Noemvri 18,6330 Struga, MACEDONIA

**Emri i projektit:**

**USHQIM PËR REFUGJATËT NGA LINDJA E MESME SI FOSHNJAT DHE FËMIJËT**

(Këto njerëz tani më kanë ngelur në rrugë pa kthim, pa të afërmit, pa të dashurit, pa shtëpi, pa shkolla dhe shumë e shumë të drejta të tjera që i takojnë njerëzimit dhe me keqardhje themi se atyre ju ka ngelur vetem jeta, andaj të japim kontributin tonë që së paku t'ua ruajmë jetën).

**Vendi i realizimit:**

**Maqedonia Veriore, Kumanovë/pika kufitare Tabanovc**



**■ APLIKUESI:**

Emri	<b>Shoqata Humanitare Bëmirëse “Nënë Tereza” - Strugë</b>		
Adresa	<b>Kej 8 Noemvri br. 18, 6330 Strugë, Maqedoni</b>		
Kontakt Celulari	<b>0038970249114</b>	e-mail	<b>motherteresastruga@gmail.com</b>
Faqja e internetit	<b>www.facebook.com/motherteresastruga</b>		

**■ PARTNERI IMPLEMENTUES / MENAXHERI I PROJEKTIT:**

Emri	<b>Shoqata Humanitare Bëmirëse “Nënë Tereza” - Strugë</b>		
Adresa	<b>Kej 8 Noemvri br. 18, 6330 Strugë</b>		
Kontakt Celulari	<b>0038970249114</b>	e-mail	<b>motherteresastruga@gmail.com</b>
Faqja e internetit	<b>www.facebook.com/motherteresastruga</b>		

**■ PERSONI PËR KONTAKT:**

Emri dhe mbiemri	<b>Jashar Pollozhani</b>		
Kontakt	<b>0038970249114</b>	e-mail	<b>jasharpollozhani1@gmail.com</b>



## ■ TITULLI I PROJEKTIT:

### •USHQIM PËR REFUGJATËT NGA LINDJA E MESME SI FOSHNJAT DHE FËMIJËT•

(Këto njerëz tani më kanë ngelur në rrugë pa kthim, pa të afërmit, pa të dashurit, pa shtëpi, pa shkolla dhe shumë e shumë të drejta të tjera që i takojnë njerëzimit dhe me keqardhje themi se atyre ju ka ngelur vetem jeta, andaj të japim kontributin tonë që së paku t'ua ruajmë jetën)

## ■ VENDI:

Republika e Maqedonisë

## ■ RAJONI/PROVINCA:

Maqedonia Veriore, Kumanovë/pika kufitare Tabanovc

## ■ KORNIZA KOHORE E PROJEKTIT:

Nga : | **05.06.2019** | Deri më : | **30.09. 2019** | Kohëzgjatja : | **90 ditë**

## ■ NUMRI DHE PËRSHKRIMI I PËRFITUESVE

Numri i refugjatëve	<b>285</b>	N° familjar	<b>70</b>
Përshkrimi i përfituesve	<b>Përfituesit janë refugjatë dhe emigrantë nga Siria, Afganistani, Iraku, Pakistani dhe vende të tjera nga Azia dhe Afrika që po qëndrojnë në Kampin e Tabanovcit</b>		
Vendi	<b>Republika e Maqedonisë</b>		



## ■ PËRSHKRIM I SHKURTËR I INTERVENIMIT

Në tre muajt e fundit 450 refugjatë dhe emigrantë kanë kaluar kufirin maqedonas sipas të dhënave nga Ministria e Brendshme.

Në periudhën e fundit ky numër është rritur me shpejtësi dhe rreth 300 refugjatë dhe emigrantë kanë kaluar kufirin në 7 ditët e fundit (mesatarisht 43 persona). Numri i refugjatëve dhe migrantëve në ditët e fundit rritet me shpejtësi për shkak të transportit më të organizuar nga pala greke. Sipas të dhënave zyrtare prej 19 qershorit deri në fund të 15 shtatorit, 90 fëmijë nga të cilët 68 ishin të pashoqëruar kanë kaluar kufirin. Sipas raportit të UNHCR-së, një nga problemet me fëmijët është ushqimi për foshnjat dhe fëmijët e vegjël.

### **QËLLIMI I PËRGJITHSHËM:**

- ✓ Për t'iu përgjigjur nevojave për refugjatët

### **OBJEKTIVAT:**

- ✓ Për të siguruar pako ushqimore fruta dhe perime te freskëta
- ✓ Grupet tona të synuara për këtë pilot projekt janë refugjatët dhe femijët që udhëtojnë pa prindër



## ■ PËRSHKRIM I DETAJUAR I PROJEKTIT

[Përshkruani gjendjen politike, ekonomike, sociale në terren, etj.]

Kriza në Lindjen e Mesme dhe lufta civile në Siri, provokuan lëvizje të mëdha dhe kriza refugjatësh nga njerëzit të cilët ikin nga ai rajon. Në 6 muajt e fundit, në Maqedoni, si një vend tranzit, kanë kaluar më shumë se 900 refugjatë dhe emigrantë.

## ■ PËRFITUESIT – PËRSHKRIM DHE KRITERIUMI I PËRZGJEDHJES

Ne dëshirojmë të ndihmojmë sepse SHHB “Nënë Tereza” ka përvojë në shpërndarjen e pakove ushqimore për refugjatët dhe sipas raporteve të UNHCR-së dhe monitorimit tonë, fusha apo pjesa e ushqimit për refugjatët dhe fëmijët është kritike për momentin. Ne do të krijojmë ekipe që do të jenë në terren dhe do të kenë qasje të drejtpërdrejtë tek përfituesit.

## ■ ZONA E PROJEKTIT

- Aktivitetet e projektit do të zbatohen në kufirin Maqedoni-Serbi ku refugjatët dhe emigrantët do të mbeten pas transportit me tren. Në pikën kufitare Tabanovc, refugjatët dhe emigrantët kanë qëndrim të shkurtër dhe pas kësaj ata kalojnë kufirin me Serbinë në këmbë.
- Ne kemi zgjedhur këtë lokacion, sepse në Gjevgjeli operojnë më shumë OJQ dhe po shpërndahet ushqim dhe artikuj të tjerë për të gjithë refugjatët dhe emigrantët. Në Tabanovc ne mund t'i qasemi lehtësisht nënave me fëmijë dhe t'u japim atyre pako për foshnjat dhe fëmijët e tyre. Në Gjevgjeli ne do të kemi koordinator që do të ketë informacione nga dora e parë dhe do të komunikojë me koordinatorin në Tabanovc për numrin aktual të foshnjave dhe të fëmijëve të vegjël që kalojnë kufirin në Gjevgjeli dhe vazhdojnë në Serbi.

## ■ ANALIZAT E PROBLEMIT

Nënat që kanë foshnje dhe fëmijë të vegjël zakonisht janë në pozita të atilla që duhet të angazhohen dhe të japin përpjekje të dyfishtë gjatë udhëtimit të tyre sepse ata duhet të kujdesen për vetveten dhe për foshnjat dhe fëmijët e vegjël gjë që është mjaft e vështirë gjatë udhëtimit të tyre drejt vendeve Evropiane. Të siguruarit e ushqimit të shëndetshëm për foshnjat dhe fëmijët e tyre është problem serioz për to për shkak se foshnjat dhe fëmijët e vegjël nuk mund të hanë gjithçka. Ky është problemi të cilin duam ta trajtojmë me këtë projekt.

## ■ LOGJIKA E INTERVENIMIT

### ■ OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM

Objektivi i përgjithshëm është të sigurohet ushqim i shëndetshëm për refugjatet dhe fëmijët e vegjël dhe të kontribuohet që ata lehtësisht të tejkalojnë vështirësitë gjatë udhëtimit të tyre.

### ■ OBJEKTIVI SPECIFIK

1. Të sigurojmë fruta te freskëta, perime dhe rrobe të mbrendshme (brekë, maica, mushama për tu mbrojtur nga shiu, çizma.
2. Ushqime energjetike.





## ■ REZULTATET E PRITURA

1. Ne presim që të arrijmë dhe sigurojmë pako për 150 refugjatë
2. Ne presim që të arrijmë të sigurojme pako ushqimore për pothuajse 450 refugjatëve në tre muajt e ardhshëm
3. Stafi dhe vullnetarët tonë do t'i ndihmojnë refugjatët dhe migrantët jo vetëm me foshnjat dhe pakot ushqimore për fëmijët, por gjithashtu me informacione për kalimin më të lehtë dhe më të shpejtë të kufirit nga ana e tyre.

## AKTIVITETE

### Cilat janë aktivitetet të cilat do të bëhen dhe në çfarë renditje në mënyrë që të prodhohen rezultatet e pritura?

1. Ekipi i angazhuar për aktivitetet zbatuese (koordinatorët në Kumanovë, 5 anëtarë të stafit)
2. Organizimi i kanaleve të komunikimit ndërmjet Gjevgjelisë dhe Kumanovës në mënyrë që t'ju përgjigjemi menjëherë nevojave të grupeve aktuale të refugjatëve dhe emigrantëve. Krijimi i ekipeve funksionale në pikën kufitare Tabanovc.
3. Të sigurojmë ushqime nga furnizuesit, të gjejmë depo dhe të organizojmë transportin në pikën kufitare Tabanovc.

## ■ RREZIQET DHE SUPOZIMET

**Rreziku:** Të kemi më shumë refugjat se sa numri mesatar deri më tani.

**Lehtësimi:** Do të ketë mundësi të hapur për të gjetur donatorë shtesë nga organizatat joqeveritare lokale ose nga kompanitë private për intervenim

**Rreziku:** Të kemi më pak refugjat dhe fëmijë sesa numri mesatar deri më tani.

**Lehtësimi:** disa nga resurset do të drejtohen kah gratë shtatzëna dhe njerëzit me aftësi të kufizuara fizike.

## ■ PLANIFIKIMI I PIKAVE (JO E DETYRUESHME)

	Data	Aktiviteti
1.	05.04.2019	Ekipi i angazhuar
2.	25.04.2019	Organizimi i kanaleve të komunikimit
3.	25.05.2019	Ftuarja e kompanive dhe mbledhja e ofertave
4.	02.06.2019	Sigurimi apo marrja e pakove të para dhe shpërndarja e tyre për fëmijët dhe foshnjat

## ■ RËNDËSIA E VEPRIMIT

Ushqimi i shëndetshëm për foshnjat dhe fëmijët është gjithmonë problem sepse ato janë kategoria më e prekshme/lënduar në raste të lëvizjeve të mëdha.

Duke intervenuar me qumësht pluhur për foshnjat dhe ushqim për fëmijët ne do ta bëjmë më të lehtë udhëtimin e tyre dhe do t'ju sigurojmë ushqim për disa kohë.



## ■ METODOLOGJIA E NDËRHYRJES

Kompanitë të cilat do të sigurojnë furnizime për pakot do ti paketojnë dhe do ti dorëzojnë ato në deponë tonë në Kumanovë. Prej atje, sipas nevojave një numër i caktuar i pakove do të transportohet në pikën kufitare. Ne do të përdorim qasjen e drejtëpërdrejtë ndaj përfituesve potencial dhe do tju shërndajmë pako drejtëpërsëdrejti nënave të foshnjeve dhe fëmijëve.

Koordinatori në Kumanovë është përgjegjës për organizimin e shpërndarjes kurse stafi/vullnetarët do tua bëjnë shpërndarjen refugjatëve dhe emigrantëve.

## ■ STRUKTURA ORGANIZATIVE E PARTNERIT

**Shoqata humanitare "Nënë Tereza" vepron në Maqedoni me degë në Strugë që nga Janari i vitit 1993. Ne filluam si një organizatë në përbërje të Shoqatës humanitare "Nënë Tereza" në Kosovë. Me regjistrimin e fundit në vitin 2010, sipas legjislacionit të ri, ne jemi një organizatë lokale në Maqedoni.**

### Struktura e organizimit:

- **Kuvendi;**
- **Bordi udhëheqës;**
- **Bordi i kontrollit të brendshëm.**

Organi më i lartë është Kuvendi. Kuvendi mban mbledhje mvarësisht nga nevojat, por të paktën një herë në vit.

Mbledhjet e kuvendit zgjedhin Kryetarin e Nënë Terezës derisa të zgjidhet kryesia e punës. Bordi udhëheqës është organ ekzekutiv kolegjal i shoqatës humanitare "Nënë Tereza".

Bordi udhëheqës mban mbledhje kurdoherë që është e nevojshme për të ushtruar të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë, si dhe në rastet kur këtë gjë e kërkon një organ i shoqatës humanitare "Nënë Tereza" ose të paktën 1/2 e anëtarëve të Bordit udhëheqës.

Mbledhjen e thërret dhe udhëheq kryetari, dhe në rastet kur ai/ajo mungon, mbledhjen e udhëheq një nga anëtarët e bordit udhëheqës të cilin e zgjedhin anëtarët e tjerë.

Bordi i kontrollit të brendshëm përbëhet prej tre anëtarësh të cilët Kuvendi i zgjedh nga anëtarët e tij.

Një anëtar i Bordit të kontrollit të brendshëm nuk mund të zgjidhet për anëtar të Bordit udhëheqës dhe organeve të tij të punës. Kryetari i Bordit të kontrollit të brendshëm zgjidhet nga bordi prej anëtarëve të tij.

Mandati i anëtarëve dhe kryetarit të bordit zgjat katër vjet me të drejtë për rizgjedhje.

Për realizimin e projektit do të krijohet ekipi i Menaxherit të projektit, dy koordinatorë të projektit dhe 4 anëtarë të stafit/vullnetarë. Menaxheri i projektit do të jetë përgjegjës për menaxhimin e aktiviteteve, detyrimeve financiare dhe raporteve.

Koordinatorët do të jenë përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve në terren dhe do të punojnë drejtëpërdrejtë me anëtarët e stafit/vullnetarët.





## REFERENCA/PËRVOJA E ORGANIZATËS PARTNER:

- Shoqata humanitare bëmirese „Nënë Tereza” – Strugë ka bashkëpunuar me Caritas Viena në periudhën 1999-2005 në projekte të ndryshme që kishin të bëjnë me krizën e refugjatëve nga Kosova dhe Maqedonia duke ndërhyrë me ushqime, medikamente, veshmbathje dhe këpucë. Pas përfundimit të krizës, ne vazhduam bashkëpunimin me disa projekte edukative dhe kulturore.
- Cap Anamur, një organizatë joqeveritare nga Gjermania. Gjatë krizës në Kosovë, ne kemi bashkëpunuar për sa i përket intervenimit me ushqim në kampet në Maqedoni dhe pas mbarimit të krizës, kemi pasur disa projekte të vogla humanitare në Kosovë deri në fund të vitit 1999.
- People in need (Njerëz në nevojë), organizatë ndërkombëtare nga Sllovakia. Shpërndarja e miellit, orizit, dhe artikujve të tjerë për kampet në Maqedoni gjatë krizës së refugjatëve në Kosovë.
- Djakonia, organizatë joqeveritare nga Gjermania. Artikuj ushqimorë për refugjatët e kthyer nga Kosova si dhe projekte të përbashkëta për ndërtimin e shtëpive në Kosovë për të rikthyerit.
- Mercy Corps International, organizatë joqeveritare nga SHBA. Artikuj ushqimorë për kampet në Maqedoni gjatë krizës së refugjatëve në Kosovë.

## ■ TË DHËNA MBI SIGURIMIN E ARTIKUJVE

Për shkak se është e nevojshme të vepohet shpejt, procedura e sigurimit të artikujve është si vijon:

Ne do të ftojme kompanitë drejtëpërdrejtë të ofrojnë çmimet e tyre, sasinë dhe cilësinë e produkteve që ne do të duhet ti sigurojmë. Për këtë, ne do të na duhen të paktën tre oferta zyrtare nga kompanitë në mënyrë që të zgjidhet më e mira. Sipas ofertave, ne do të zgjedhim kompaninë që ka standardet minimale të cilësisë dhe çmimin më të mirë të ofruar.

## ■ MONITORIMI DHE VLERËSIMI

**Monitorimi dhe vlerësimi i projektit do të bëhet në disa nivele të ndryshme:**

- **Monitorim dhe vlerësim ditor nga koordinatorët dhe stafi/vullnetarët;**
- **Monitorim dhe vlerësim javor nga ana e menaxherit të projektit;**
- **Raport dhe vlerësim mujor nga ana e menaxherit të projektit ndaj donatorëve;**
- **Monitorim dhe vlerësim nga përfaqësuesit e donatorëve kurdo që ata duan.**





## ■ BUXHETI (EURO)

<b>Buxheti total</b>		<b>11.568,72</b>
Kontributi vetanak		800,00
<b>Fonde të tjera</b> (kush, në çfarë shume)	<b>1.</b>	<b>000,00</b>
Donatorët public, OJQ-të, donatorë më të mëdhenj	<b>2.</b>	<b>000,00</b>
	<b>3.</b>	<b>000,00</b>
	<b>Totali i fondeve të tjera:</b>	<b>000,00</b>
*****		<b>10.768,72</b>

## ■ TË DHËNA MBI BANKËN

<b>Emri i bankës</b>	Stopanska Banka AD Skopje, Filiali Strugë (za Majka Tereza)		
<b>Adresa e bankës</b>	Marsal Tito 54, 6330 Strugë, Maqedoni		
<b>SWIFT</b>	<b>STOBMK2X</b>	<b>IBAN</b>	<b>MK07200000790115626</b>
<b>Numri i identifikimit të bankës</b>			
<b>Numri i llogarisë</b>	<b>0720000790115626</b>		
<b>Mbajtësi i llogarisë</b>	Humanitarno dobrocinitelno zdruzenie Majka Tereza		
<b>Adresa e mbajtësit të llogarisë</b>	Kej 8 Noemvri br. 18, 6330 Strugë, Maqedoni		
<b>Banka lidhëse</b>			

Data: 21.01.2019  
në Strugë

SH.H.B. „NËNA TEREZE”-Strugë

/Jashar Pollozhani/